



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.31/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj kryesues, Skënder Çoqaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Obiliq, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Obiliq, për shkak të mbajtjes së tubimeve publike në objekte fetare për qëllime elektorale të subjektit politik LVV, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.31/2025 e datës 14.01.2025, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Obiliq, me pretendimin se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Obiliq, ka mbajtur tubim publik në objekte fetare.

A r s y e t i m

Me datën 14.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike (LDK) dega në Obiliq, në të cilën pretendohet se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka mbajtur takim në odën e xhamisë në Kozaric me 13.01.2025, përkundër se janë të ndaluara këto tubime në objektet e kultit. Parashtuesi i ankesës kërkon që të merren masa ndaj këtij subjekti dhe për të cilat pretendime në ankesë thekson se posedojnë dëshmi si foto të postuara në facebook të cilat i ka bashkangjitur ankesës fotot e printuara.

Më datë 14.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 15.01.2025 në ora 10:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 15.01.2025, subjekti politik LVV e kundërshton pretendimin e subjektit politik LDK, me arsyetimin se më datë 13.01.2025 është mbajtur një tubim nga kandidatet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV). në Komunën e Obiliqit, ku të pranishëm ishin një numër i qytetareve në një odë e cila emërtimin e saj e ka si “Oda e Xhamisë”, dhe ky emërtim nuk mund të merret si pikë reference për përcaktimin se kjo odë është pjesë e Bashkësisë Islame të Kosovës. Marrja e këtyre fakteve si të mirëqena dhe pa u verifikuar mirë nga ana e subjektit politik LDK, mund të quhet mungesë e etikës profesionale andaj parashtruesi i përgjigjes në ankesë subjekti Lëvizja Vetëvendosje, konsideron se kjo ankesë bie ndesh me nenin 34 pika 1.10 e cila e ndalon dërgimin e ankesave të tilla, i cili nen shprehimisht parashihet se *“Abuzimi me të drejtën e ankesës, ose duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme, të pavlera dhe irrituese në PZAP”*. Pretendimet se prona është pjesë integrale e Xhamisë së Fshatit e që subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka shkelur rregullat zgjedhore, mund të demantohen me shikimin e pronësisë së këtij objekti i cili nuk është as pjesë e as pronë e Xhamisë, por është pronë private. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, ka bashkangjitur si provë të dhënat nga Agjencia Kadastrale për vërtetimin se objekti ku është mbajtur tubimi nuk është pjesë apo pronë e xhamisë por është pronë private.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur që me sukses t'i argumentojë pretendimet e veta, pasi që nga fotografitë të cilat paraqitësi i ka bashkangjitur si dëshmi ankesës, nuk mund të vërtetohet se nga ana e subjektit politik LVV, është përdorur ndonjë objekt fetar për fushatë zgjedhore.

Nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehen vetëm se është realizuar një tubim nga ana e subjektit politik LVV, në të cilin tubime kanë marrë pjesë disa persona, por nuk është i argumentuar në asnjë moment në mënyrë të qartë dhe bindëse se ndonjë tubim është mbajtur në objekt fetar gjegjësisht në xhamin e fshatit ashtu siç pretendohet nga pala

ankuese, pasi që nga të gjitha fotografitë e dorëzuara si provë nuk mund të vërehet asnjë shenjë –simbole fetare apo ndonjë element i objektit fetar-xhamisë.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.31/2025 më datën 15.01.2025

Kryesues i Panelit

Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.31/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj kryesues, Skënder Çoqaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Obiliq, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Obiliq, për shkak të mbajtjes së tubimeve publike në objekte fetare për qëllime elektorale të subjektit politik LVV, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.31/2025 e datës 14.01.2025, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Obiliq, me pretendimin se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Obiliq, ka mbajtur tubim publik në objekte fetare.

A r s y e t i m

Me datën 14.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike (LDK) dega në Obiliq, në të cilën pretendohet se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka mbajtur takim në odën e xhamisë në Kozaric me 13.01.2025, përkundër se janë të ndaluara këto tubime në objektet e kultit. Parashtuesi i ankesës kërkon që të merren masa ndaj këtij subjekti dhe për të cilat pretendime në ankesë thekson se posedojnë dëshmi si foto të postuara në facebook të cilat i ka bashkangjitur ankesës fotot e printuara.

Më datë 14.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 15.01.2025 në ora 10:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 15.01.2025, subjekti politik LVV e kundërshton pretendimin e subjektit politik LDK, me arsyetimin se më datë 13.01.2025 është mbajtur një tubim nga kandidatet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV). në Komunën e Obiliqit, ku të pranishëm ishin një numër i qytetareve në një odë e cila emërtimin e saj e ka si “Oda e Xhamisë”, dhe ky emërtim nuk mund të merret si pikë reference për përcaktimin se kjo odë është pjesë e Bashkësisë Islame të Kosovës. Marrja e këtyre fakteve si të mirëqena dhe pa u verifikuar mirë nga ana e subjektit politik LDK, mund të quhet mungesë e etikës profesionale andaj parashtruesi i përgjigjes në ankesë subjekti Lëvizja Vetëvendosje, konsideron se kjo ankesë bie ndesh me nenin 34 pika 1.10 e cila e ndalon dërgimin e ankesave të tilla, i cili nen shprehimisht parashihet se *“Abuzimi me të drejtën e ankesës, ose duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme, të pavlera dhe irrituese në PZAP”*. Pretendimet se prona është pjesë integrale e Xhamisë së Fshatit e që subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka shkelur rregullat zgjedhore, mund të demantohen me shikimin e pronësisë së këtij objekti i cili nuk është as pjesë e as pronë e Xhamisë, por është pronë private. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, ka bashkangjitur si provë të dhënat nga Agjencia Kadastrale për vërtetimin se objekti ku është mbajtur tubimi nuk është pjesë apo pronë e xhamisë por është pronë private.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur që me sukses t'i argumentojë pretendimet e veta, pasi që nga fotografitë të cilat paraqitësi i ka bashkangjitur si dëshmi ankesës, nuk mund të vërtetohet se nga ana e subjektit politik LVV, është përdorur ndonjë objekt fetar për fushatë zgjedhore.

Nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehen vetëm se është realizuar një tubim nga ana e subjektit politik LVV, në të cilin tubime kanë marrë pjesë disa persona, por nuk është i argumentuar në asnjë moment në mënyrë të qartë dhe bindëse se ndonjë tubim është mbajtur në objekt fetar gjegjësisht në xhamin e fshatit ashtu siç pretendohet nga pala

ankuese, pasi që nga të gjitha fotografitë e dorëzuara si provë nuk mund të vërehet asnjë shenjë –simbole fetare apo ndonjë element i objektit fetar-xhamisë.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.


Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.31/2025 më datën 15.01.2025

Kryesues i Panelit

Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform neni 118 paragrafi 4 të LZP-së.